



Prishtinë, 21.09.2023
11:00 h

RENDI I DITËS
Mbledhja e nëntë (IX) e Bordit të ZRRE-së
për vitin 2023

1. Miratimi i Rendit të Ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
3. Shqyrtim i Kërkesës/aplikacionit për vazhdimin e Licencës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga TC Kosova A për ndërmarrjen Korporata Energjetike e Kosovës – KEK SH.A.;
4. Shqyrtim i Kërkesës/aplikacionit për dhënien e Licencës për Furnizim me Shumicë (tregti) të energjisë elektrike për shoqërinë INFINIT POWER SOLUTION SH.P.K.;
5. Shqyrtim i Kërkesës/aplikacionit për dhënien e Licencës për Furnizim me Shumicë (tregti) të energjisë elektrike për shoqërinë SOLE 24 SHPK Dega në Kosovë;
6. Shqyrtimi i kërkesës/Aplikacionit për lëshimin e autorizimit për ndërtim të projektit solar/fotovoltaik të shoqërisë ECO PARK GROUP SH.P.K.;
7. Shqyrtimi i Draft/Marrëveshjes për Blerje Të Energjisë Elektrike sipas Skemës Mbështetëse të Faturimit NETO;
8. Shqyrtimi i Draft/Marrëveshjes për Blerje Të Energjisë Elektrike Jashtë Skemës Mbështetëse;
9. Shqyrtimi i kërkesë së KOSTT për miratimin e Rregullës për Alokimin në Hije (“Shadow”)
10. Shqyrtimi i kërkesë së KOSTT për miratimin e Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës
11. Shqyrtimi i kërkesë së KOSTT për miratimin e Procedurës Rezervë për Bashkimin E Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë;
12. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Propozimin për aprovimin e produkteve dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a;
13. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Propozimin për aprovim mbi mënyrën e tregtimit të kontratave të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (Over the Counter - OTC) midis shoqërive që nuk ju është vendosur detyrimi për shërbimin publik, në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.
14. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Propozimin për aprovimin e rregullit të përcaktimit të Urdhërporosive fituese në rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht sipas parashikimeve të seksionit B.2.1 të Procedurës së Tregtimit.
15. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Propozimin për aprovim e përcaktimit të Portofoleve të Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi



(Shitjeje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

16. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Propozimin për aprovim të Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë për Tregun e Kosovës;
17. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me aprovimin e Kufirit Minimal dhe Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum and Minimum Price Threshold), për të cilin ALPEX-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë, sipas përcaktimeve të Procedurës së Tregtimit;
18. Shqyrtimi i kërkesë së ALPEX lidhur me Aprovimin e Procedurës së Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a;
19. Shqyrtimi i propozimit të ALPEX për miratimin e Çmimeve Maksimale dhe Minimale të Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë;
20. Shqyrtimi i propozimit për tarifa të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) për zonën e ofertimit të Kosovës;
21. Shqyrtimi i Kontestit në mes KOSTT dhe KEK për faturën e jobalancit për periudhën 12/2021;
22. Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve;
23. Të tjera.